



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep.	Nr. Prot. Bi Prot.
DPKI	06-1614/20
Nr. l faq Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
07	05-08-2020
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nëparagrafi 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nëparagrafi 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 30.07.2020, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPKI-06-2237/19*, për zyrtarin e lartë z. Shpëtim Sadiku, Anëtar i Komisionit për Verifikim dhe Vendosje të Pronave në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i bapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë publik z. Shpëtim Sadiku, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi që është identifikuar se zyrtari i lartë z. Shpëtim Sadiku, Anëtar i Komisionit për Verifikim dhe Vendosje të Pronave në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (në vijim: Anëtar i KVVP), njëkohësisht ushtron veprimtari profesionale të avokatisë dhe është person i autorizuar në biznesin privat "Shpëtim R. Sadiku" B.I (Avokat Shpëtim Sadiku), që ndërlihet me veprimtarinë e avokatisë.

Agjencia kundër Korrupsionit (në vijim: Agjencia), me shkresën zyrtare DPKI-06-2336/19, e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, janë organizuar dhe mbajtur dy takime me zyrtarin e lartë në zyrat e Agjencisë, me ç'rast z. Shpëtim Sadiku është njoftuar me faktet që posedon Agjencia, si dhe është udhëzuar për veprimet që duhet t'i ndërmerr për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ushtrimi i veprimtarisë profesionale të avokatisë duke qenë njëkohësisht zyrtar i lartë publik si Anëtar i KVVP-së, është i ndaluar me nenin 12 paragrafi 1 LPKI-së. Dispozita në fjalë përcakton se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë veprimtari profesionale të avokatisë, noterisë, përmbartuesit privat, administratorit të falimentimit, ekspertit të licencuar, konsulentit ose agjentit të personave juridikë si dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër”.

Gjithashtu, zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë person i autorizuar në biznes privat, për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohet me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të LPKI-së, ku përcaktohet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni”.

Ndërsa me nenin 19 të LPKI-së parashihen masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave. Dispozitat e nenit në fjalë përcaktojnë se:

1. Në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari sipas rastit dhe rrethanave:

1.1. transferon interesin privat dhe të drejtat në drejtimin e ndërmarrjes sipas përcaktimeve të nenit 15 të këtij ligji; [...];

1.3. jep dorëheqjen nga detyrat, funksionet ose veprimtaritë që janë në konflikt ose të papajtueshme me funksionin e tij publik;

1.4. dorëhiqet nga funksioni publik.

Zyrtari i lartë z. Shpëtim Sadiku, në takimet e mbajtura dhe përmes shkresës sqaruese të dorëzuar në Agjenci (DPKI-06-2950/19), nuk e ka mohuar faktin se më datë 30.03.2018, është emëruar Anëtar i KVVP-së nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe se ushtron veprimtari profesionale të avokatisë (Avokat), e si rrjedhojë është edhe person i autorizuar i biznesit privat që lidhet me ushtrimin e veprimtarisë së avokatisë. Por, ka deklaruar se edhe pse është emëruar Anëtar i KVVP-së, asnjëherë nuk e ka ushtruar faktikisht këtë funksion dhe asnjëherë nuk është kompensuar për këtë funksion. Duke pretenduar se, dispozitat e LPKI-së nuk kanë sanksionuar konfliktin e interesit vetëm mbi bazën e të qenurit i zgjedhur apo i emëruar si zyrtar publik, pa e ushtruar dhe pa u kompensuar për atë funksion.

Ndërkohë z. Shpëtim Sadiku ka paraqitur në Agjenci shkresën (DPKI-06-2336-1/19), me të cilën Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, duke u përgjigjur në kërkesën e tij, e njofton se Komisioni për Verifikim dhe Vendosi të Pronave nuk është funksional për shkak se nuk janë emëruar anëtarët ndërkombëtarë të këtij Komisioni.

Se z. Shpëtim Sadiku është Anëtar i KVVP-së dhe njëkohësisht ushtron veprimtarinë profesionale të avokatisë, përveç tjerash, vërtetohet edhe nga Regjistrat për deklarimin e pasurisë (2018, 2019 dhe 2020), ku në rubrikën “Funksionet dhe aktivitetet që i kryen zyrtari i lartë publik”, ka deklaruar se është duke ushtruar funksionin Komisioner (Anëtar i Komisionit për Verifikim dhe Vendosje të Pronave) dhe Avokat (veprimtari profesionale të avokatisë).

Sa i përket pretendimeve të z. Shpëtim Sadiku lidhur me dilemat nëse është zyrtar i lartë apo jo, pasi që nuk ushtron faktikisht funksionin e Anëtarit të KVVP-së dhe nuk është kompensuar për këtë funksion, Agjencia ka konstatuar se duke qenë Anëtar i KVVP-së, i emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, z. Shpëtim Sadiku është zyrtar i lartë publik në kuptim të nenit 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i LPKI-së, me të cilin përcaktohet se:

“Zyrtar i lartë – nënkupton zyrtarët e lartë publikë të përcaktuar sipas Ligjit përkatës për deklarimin, kontrollin dhe prejardhjen e pasurisë”,

... lidhur me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.6 të Ligji Nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, me të cilin është përcaktuar se:

“Zyrtar i Lartë Publik - janë: [...] Anëtarët e Bordeve të Ndërmarrjeve Publike, anëtarët e Bordeve të Rregullatorëve, të Komisioneve apo Agjencive tjera të themeluara me ligj apo me ndonjë akt tjetër”.

Siç mund të shihet, me dispozitat e sipërcituara nuk kërkohet që për të qenë “zyrtar i lartë publik” nevojitet edhe “ushtrimi faktik i funksionit dhe kompensimi për atë funksion”, por mjaft qartë përcaktohet se “zyrtar i lartë publik” janë, përveç tjerash, edhe “anëtarët e Komisioneve të themeluara me ligj”. Pra, mjafton fakti që z. Shpëtim Sadiku është Anëtar i KVVP-së, i emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, fakt ky i pakontestuar nga vet z. Shpëtim Sadiku, në mënyrë që të konsiderohet zyrtar i lartë publik, e rrjedhimisht të krijohet obligimi për zbatimin e kufizimeve dhe ndalesave për zyrtarët e lartë publik, që dalin nga dispozitat e LPKI-së.

Për më tepër, fakti se z. Shpëtim Sadiku ka deklaruar pasurinë në cilësinë e Anëtarit të KVVP-së, dhe atë për tre vite rresht, e përforcon konstatimin e sipërmënuar të Agjencisë. Sepse vetëm zyrtarët e lartë publik janë të obliguar të bëjnë deklarimin e pasurisë në kuptim të dispozitave të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Rrjedhimisht, Agjencia ka konstatuar se ushtrimi i veprimtarisë profesionale të avokatisë nga z. Shpëtim Sadiku dhe të qenurit përfaqësues i autorizuar i biznesit privat që lidhet me veprimtarinë e avokatisë, duke qenë njëkohësisht edhe Anëtar i KVVP-së, zyrtar i lartë publik, është në kundërshtim me dispozitën e nenit 12 paragrafi 1 dhe nenin 13 paragrafi 1 të LPKI-së.

Pasi që z. Shpëtim Sadiku, as pas rekomandimeve dhe udhëzimeve që i ka dhënë Agjencia në takimet e mbajtura, nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për shmangie të situatës së konfliktit të interesit, Agjencia në kuptim të nenit 22 paragrafi 7 të LPKI-së, të njëjtit i ka dërguar “Njoftim paralajmërues për konstatimin e konfliktit të interesit” (DPKI-06-3275/19), me të cilin e ka

njoftuar zyrtarin e lartë me konstatimin e situatës së konfliktit të interesit, si dhe ka kërkuar nga zyrtari i lartë që brenda afatit shtatë (7) ditë nga pranimi të njoftimit, të ndërmer veprime konkrete (masat) për shmangie të situatës së konfliktit të interesit, konform nenit 19 të LPKI-së. Me paralajmërimin se, në të kundërtën Agjencia do të veproi konform nenit 22 paragrafi 8 dhe nenit 23 të LPKI-së.

Pas kësaj, z. Shpëtim Sadiku ka njoftuar me shkrim Agjencinë (DPKI-06-02/20), se duke vepruar sipas njoftimit paralajmërues për konstatimin e konfliktit të interesit të Agjencisë, ka dorëzuar dhe protokolluar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Kërkesën për pezullim të pozitës së Anëtarit të KVVP-së, përkatësisht për dorëheqje nga kjo pozitë. Shkresës njoftuese ia ka bashkangjitur edhe kërkesën e dorëzuar dhe protokolluar në Kuvendin e Republikës së Kosovës (nr. Prot. 1541/19).

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar njoftimin zyrtar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (DPKI-06-1580/20), me të cilën konstatohet se Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, ka pranuar kërkesën për dorëheqje të z. Shpëtim Sadiku, nga pozita Anëtar i KVVP-së.

Pas analizimit të njoftimit dhe konfirmimit të pranuar, Agjencia konstatoi se zyrtari i lartë z. Shpëtim Sadiku, ka dhënë dorëheqje nga funksioni publik, dhe se kërkesa për dorëheqje i është pranuar nga Komisioni Funkcional përkatës i Kuvendit të Kosovës, sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të LPKI-së. Në këtë mënyrë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtari i lartë, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, pasi që z. Shpëtim Sadiku nuk mbanë më funksion të zyrtarit të lartë publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

